



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, prill 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Arvita Zyferi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Luljeta Sylaj udhëheqës i ekipit, Bahri Statovci dhe Mazlumsha Sejfadini anëtarë, nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	22
Shtojca II: Letër konfirmimi	25

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), për vitin 2019, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore të MAPL-së të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2019, që ndërlidhen me pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit dhe shpalosjet për këto pasqyra janë të plota dhe të sakta.

Menaxhimi financiar dhe kontrollet e brendshme në përgjithësi janë të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, mirëpo kërkojnë angazhim të mëtejshëm për të eliminuar mangësitë tek realizimi i pagesave dhe pasuritë.

Ministria i është përgjigjur pozitivisht rekomandimeve të vitit paraprak, ku është vërejtur një angazhim i shtuar në zbatimin e tyre.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht, shih kapitullin 1 të raportit.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të MAPL-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i MAPL-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë e detyrimet si dhe funksionimin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet e brendshme të MAPL-së në përgjithësi janë zbatuar nga menaxhmenti dhe janë treguar efektive në parandalimin e parregullsive. Megjithatë, mos zbatimi me konsistencë i rregullave dhe obligimeve statutores, ka shkaktuar mangësi në shpenzimin e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve dhe në menaxhimin e pasurisë.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	12,201,508	12,220,825	4,760,820	39	4,834,107	4,434,677
Granti i Qeverisë -Buxheti	4,201,508	3,949,529	3,714,414	94	4,676,584	4,331,066
Të hyrat nga AKP	1,000,000	941,275	919,787	98	0	0
Klauzola e investimeve	7,000,000	7,000,000	0	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	330,021	126,619	38	157,523	103,611

Nëse krahasohet buxheti final dhe realizimi i tij për 2019 MAPL i bie të ketë shpenzuar 39% të tij, mirëpo kur përjashtohen mjetet nga fondi, Klauzola e Investimeve të cilat nuk janë alokuar, atëherë realizimi i buxhetit rezulton në 91%.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në total ishte rritur për 19,317€. MAPL gjatë vitit kishte pranuar grante nga donatorët në vlerë 330,021€, ndërsa me vendime të qeverisë për ndarje dhe kursime buxhetore, buxheti i saj ishte zvogëluar për 310,704€.

Vlen të theksohet se buxheti i paraparë për financimin nga klauzola e investimeve/financimi nga huamarrja e jashtme për projektet kapitale, nuk është alokuar për shpenzim tek ministria, për shkak se marrëveshjet nuk janë ratifikuar në Kuvendin e Kosovës.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Ministria gjatë vitit 2019, ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 4,760,820€, duke përjashtuar mjetet e klauzolës së investimeve. Derisa në vitin paraprak MAPL për tërë vitin ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 4,834,107€. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	12,201,508	12,220,825	4,760,820	39	4,834,107	4,434,677
Pagat dhe Mëditjet	1,061,577	1,069,763	1,022,588	96	1,018,893	971,081
Mallrat dhe Shërbimet	314,431	447,449	254,288	57	242,033	192,284
Shërbimet komunale	15,500	17,630	8,394	48	12,547	11,895
Subvencionet	0	0	0	0	46,815	184,611
Investimet Kapitale	10,810,000	10,685,983	3,475,550	33	3,513,819	3,074,806

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 8,186€. Kjo rritje vjen si rezultat i ndryshimit në mes të granteve të donatorëve për 101,873€ dhe zvogëlimit me vendim të Qeverisë (nr. 03/115 të datës 17/12/2019), në emër të kursimeve buxhetore për 93,687€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime kishte rritje në krahasim me buxhetin fillestar për 133,018€. Kjo rritje ishte si rezultat i granteve të donatorëve në vlerë 218,018€. Megjithatë, me vendimin e Qeverisë nr.02/113, nga ky buxhet në emër të kursimeve janë marrë 45,000€, ndërsa me vendimin 03/115 të datës 17/12/2019 janë marrë edhe 40,000€ shtesë.
- Tek shpenzimet komunale, buxheti në total kishte rritje për 2,130€. Ky buxhet ishte rritur nga grantet e donatorëve për 10,130€ dhe ishte reduktuar për 5,000€, me vendimin e Qeverisë nr.02/113 dhe për 3,000€ me vendimin tjetër nr. 03/115.
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 124,018€. Ky zvogëlim është bërë me vendimin e qeverisë nr.02/113 ku në emër të kursimeve i ishin marrë 106,885€ si dhe me vendimin e muajit dhjetor nr. 03/115 i ishin marrë edhe 17,132€ shtesë. Kjo për shkak se komunat nuk kishin realizuar projektet sipas planit dhe rrjedhimisht MAPL nuk kishte arritur ta shpenzoj buxhetin nga kjo kategori.

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për kategorinë paga dhe mëditje ishte në vlerë 1,069,763€, prej tyre ishin shpenzuar 1,022,588€. Numri i lejuar i të punësuarve sipas buxhetit ishte 154 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 137, ndërsa 3 të punësuar ishin jashtë listës së pagave e të cilët paguhen nga donacionet. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 3 punëtorë të rinj. Kemi testuar 30 mostra për teste substanciale në vlerë 24,932€, si dhe 9 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Ne kemi testuar edhe menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në fushën e personelit. Ne kemi vërejtur disa lëshime të vogla të cilat nuk kanë pasur ndikim në rregullsinë e procesit dhe janë raportuar verbalisht.

Vlen të theksohet se në Raportin e Auditimit për MAPL-në në vitin 2018 është raportuar për mungesën e evidencave për vijueshmëri në punë për stafin e angazhuar bazuar në marrëveshjen e Brukselit³, përmes së cilës ishin angazhuar 18 nëpunës në kuadër të kësaj ministrie. Aktualisht punonjësit kanë filluar të raportojnë në baza javore dhe të nënshkruhen në librin e vijueshmërisë së hyrje dhe daljeve për 2019.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2019 ishte 465,079€, prej tyre ishin shpenzuar 262,682€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me udhëtime jashtë vendit, shërbime kontraktuese, shpenzime karburanti, shpenzime të qirasë, dreka zyrtare, etj. Kemi testuar 10 mostra për teste substanciale në vlerë 62,030€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

³ Ligjin nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës "Mbrojta Civile" e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministrinë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore.

Çështja B1**Avancet e pambyllura nga vitet paraprake****E gjetura**

Në bazë të rregullës financiare nr.01/2013 MF- shpenzimi i parave publike dhe udhëzimit administrativ për udhëtime zyrtare nr. MShP 2004/7, avanset për udhëtime zyrtare duhet të mbyllen dhe shumat e pashpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

MAPL, në nenin 20 në Raportin Vjetor Financiar (RVF), kishte paraqitur vlerën prej 5,945€, avance të paarsyetura për udhëtime zyrtare nga vitet paraprake 2010-2014. MAPL kishte dëshmi se avancet ishin mbyllur, mirëpo në SIMFK ato ende figurojnë të hapura. MAPL kishte bërë kërkesë në Thesar për t'i korigjuar avanset e mëhershme duke dërguar dokumentacionin e duhur dhe ishte në pritje të korigjimit të pjesës së mbetur të avanseve të hapura nga Thesari. Çështja e njëjtë ishte raportuar edhe në raportin tonë të auditimit për vitin 2018.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos koordinimit të mirë në mes të zyrtariëve përgjegjës të MAPL-së dhe Thesarit.

Ndikimi

Mungesa e veprimeve konkrete lidhur me mbylljen e avanceve ndikon në mos evitim të gabimeve në llogarinë e avanceve, dhe pasqyron shpenzime të pambyllura duke bërë që kjo llogari të figurojë e hapur në vazhdimësi. Po ashtu, informatat e prezantuara në RVF nuk prezantojnë gjendjen reale të avanceve të ministrisë.

Rekomandimi B1

Ministri në bashkëpunim me Thesarin të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dëshmitë e siguruar nga MAPL-ja, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në RVF.

Çështja A1 **Pagesa jo në pajtim me marrëveshjen dhe jashtë kompetencave të MAPL-së****Gjetja**

Sipas Rregullores së Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka një numër të caktuar të kompetencave, të qarta dhe konkrete, për përkrahjen e komunave në fusha të ndryshme të administrimit të pushtetit lokal. Ndërsa Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si përfaqësuese e aksionarit të Ndërmarrjeve Publike, ndan subvencione për përkrahjen e Ndërmarrjeve qendrore dhe regjionale varësisht nga nevojat e tyre.

Me datën 25.06.2019, Komuna e Mitrovicës së Veriut i është drejtuar me kërkesë MAPL-së për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për Kompaninë Rajonale KRU Mitrovica. Me datën 25.06.2019, ministria nxjerr vendimin duke e aprovuar kërkesën e komunës për ndarjen e 20,000€, nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime. Më tutje, në po të njëjtën datë nënshkruhet marrëveshja e mirëkuptimit për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për KRU Mitrovica nga Ministria e MAPL-së dhe Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Veriut, në vlerë 20,000€. Sipas nenit 3 të kësaj marrëveshje pagesat nga MAPL do të bëhen në bazë të faturës së shpenzimit të energjisë elektrike për KRU Mitrovica.

Duke u bazuar në kompetencat që i ka të përcaktuara kjo ministri, nuk i takon të marrë përsipër mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike të Kompanisë Rajonale KRU Mitrovica. Më tutje, buxheti i paraparë me ndarje buxhetore i MAPL-së për përkrahjen e komunave bëhet nga kategoria ekonomike investime kapitale dhe jo nga kategoria mallra dhe shërbime.

Më tutje, kemi vërejtur se pagesa nuk është bërë për energji elektrike siç ishte paraparë në marrëveshje, por ishin paguar faturat e ujit të lëshuara nga KRU Mitrovica. Faturat e ujit ishin për muajin dhjetor 2013 dhe dy për shkurt dhe mars të vitit 2014⁴. MAPL kishte paguar kompaninë e ujit nga kodi ekonomik shërbime kontraktuse tjera në vlerë 19,523€, meqenëse mjetet për të mbuluar këtë marrëveshje nuk ishin buxhetuar fare. Mjetet ishin marrë nga projekti “Ofrimi i shërbimeve profesionale në implementimin e projekteve kapitale”, i cili nuk ishte realizuar.

Sipas ministres, asistenca financiare ndaj KRU Mitrovica kishte për qëllim përkrahjen e qytetarëve të komunës për tu qasur në ujë të pijes si një e drejtë e garantuar.

⁴ Fatura nr. 0038456 me vlerë 6,314€, 0048063 me vlerë 6,314€ dhe 0256374 me vlerë 6,895€.

Ndikimi Lidhja e marrëveshjes së mirëkuptimit me Komunën për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për KRU Mitrovicën është jashtë kompetencave/fushëveprimit të kësaj ministrie. Më tej, realizimi i pagesës nga një buxhet i paplanifikuar dhe jo në bazë të marrëveshjes ndikon në procedimin e pagesave të parregullta.

Rekomandimi A1 Ministri të siguroj se marrëveshjet e mirëkuptimit të cilat të lidhen për financimin e organizatave tjera buxhetore të bëhen brenda kompetencave të parapara ligjore dhe përmes kategorive ekonomike në të cilat buxhetohen fonde për këto qëllime. Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve, të respektohen në plotësi kushtet e saj në mënyrë që të evitohen pagesat e parregullta.

2.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,685,983€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 3,475,550€. Ato kanë të bëjnë me katër projekte të aprovuara në PIP, si: Bashkëfinancimi me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancën komunale; Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio ekonomike; Ndriçimi publik për fshatin Kabash-Korishë, dhe për Pajisje të Teknologjisë Informative. Mjetet shpenzohen bazuar në marrëveshjet e mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projekteve me komunat. Qëllimi i MAPL-së është rritja e cilësisë së jetës së qytetarëve, si dhe zhvillimi i kapaciteteve infrastrukturore. Ne kemi testuar 75 mostra për teste substanciale në vlerë 3,446,903, si dhe 9 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 Përkrahja e projekteve kapitale për komuna pa kritere

E gjetura Ligji Nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, neni 17 paragrafi 6 parasheh se “për çdo financim ose bashkëfinancim të projekteve në nivel lokal mbi financimin e rregullt komunal, organizatat buxhetore qendrore duhet të zbatojnë kritere specifike, të qarta, të drejta dhe transparente. Këto kritere duhet të marrin parasysh zhvillimin e balancuar komunal dhe ndërkomunal në ndërtimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve”.

Përveç kriterëve të caktuar nga MAPL për ndarjen e mjeteve për komuna nga granti i performancës dhe kriteret e caktuar në thirrjen publike për fondet e bashkëpunimit ndër-komunal, MAPL kishte bërë ndarjen e mjeteve financiare tjera për financimin e projekteve kapitale të komunave, vetëm përmes vendimeve të ministres pa caktuar ndonjë kriter. Përmes këtyre vendimeve ishin financuar 16 projekte të komunave kryesisht serbe në vlerë 596,225€. Këto financime ministria i kishte arsyetuar me faktin se komunat në fjalë nuk kishin përfituar nga dy skemat e para dhe qëllimi i ministrisë ishte që të gjitha komunat të përkrahen financiarisht nga MAPL.

Ndikimi Ndarja e mjeteve financiare për komunat pa zbatuar kritere të qarta, specifike dhe transparence ndikon në trajtim dhe financimin jo të drejtë dhe të barabartë të komunave.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj se para financimit të të gjitha projekteve kapitale të komunave, do të caktohen kritere specifike, të qarta, të drejta dhe transparente siç parashihet me ligjin për ndarjet buxhetore.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në RVF e pasurive kapitale ishte 2,914,156€, e pasurive jokapitale është 72,620€, si dhe e stoqeve 4,931€. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 4,227,950,⁵ si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C1 Nënvlërësimi i pasurive jo financiare kapitale

Gjetja Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo-financiare në OB, neni 12 thekson se organizatat mund të blejnë dhe ndërtojnë pasuri përmes bashkëfinancimit dhe deri në momentin e pranimit të pasurisë jofinanciare, ato do të regjistrojnë transaksionin në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jofinanciare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimit nga ana e OB, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e OB-së pranuese dhe OB-së bashkë-financuese. Pasuria më pas regjistrohet në regjistrin e pasurisë së OB-së pranuese.

MAPL gjatë vitit 2018 në bazë të marrëveshjeve të bashkëfinancimit me komunat, kishte financuar projekte të ndryshme kapitale për komunat e Republikës së Kosovës. Këto financime, MAPL i kishte regjistruar në regjistrin e pasurive të saj si investime në vijim. Pas kryerjes së obligimit të ministrisë, MAPL kishte kërkuar nga Ministria e Financave (MF) që të largohen këto investime në vijim nga regjistrat e pasurisë me arsyetimin se e kishte kryer obligimin e vet financiar. Me këtë rast, MF, kishte shlyer projektet nga regjistri i pasurisë së MAPL-së, derisa të njëjtat nuk ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë së komunave përkatëse. Pas pranimit të raportit tonë të auditimit për vitin 2018, ministria kishte ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta korrigjuar gabimin ku prej 739,018€, sa ishin pasuri të shlyera në 2018, në vitin 2019 kishin mbetur edhe 300,000€ të pa korrigjuara. Vlera e pa korrigjuar ka të bëjë me projektin e financuara dhe të përfunduara që ndërlidhen me Komunën e Leposaviqit.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së zyrtarit të pasurisë dhe regjistrit të pasurisë në komunën e cila ka bërë pranimin e kësaj pasurie. Aktualisht MAPL, i ka rikthyer në regjistrin e saj të vitit 2020 këto pasuri.

Ndikimi Shlyerja e pasurive të regjistruara si investime në vijim nga MAPL pa u konsultuar me komunat përkatëse, dhe pa bërë marrëveshje me to, ka ndikuar që këto pasuri të mos rezultojnë në asnjë regjistër të vitit 2019 përfshirë regjistrat e komunës përfituese.

⁵ Në vlerën e testuar janë përfshirë pasuritë e viti 2019, transferimi i pasurive kapitale tek komunat përfituese, testimi i saldoeve të pasurive për vitin paraprak.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet përmes bashkëfinancimit me komunat, të cilat regjistrohen si investime në vijim në regjistrin e pasurive të ministrisë, nuk fshihen nga regjistrat, pa u siguruar se është bërë marrëveshje transferi, janë pranuar teknikisht dhe mund të regjistrohen në regjistër të pasurisë së komunës përfituese.

2.3 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 6,811€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Ato kishin të bënin me obligime për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale. Përveç një fature, të gjitha faturat tjera ishin brenda afatit të pagesës, më pak se 30 ditë.

Ministria zbaton një proces të rregullt të raportimit të obligimeve dhe zyrtari përgjegjës raporton me kohë në thesar obligimet e papaguara. MAPL nuk ka obligime kontraktuale.

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me tre zyrtarë - Drejtori i NJAB-së dhe dy auditorë, të cilët kanë përgatitje dhe kualifikim të duhur. NJAB, ka përgatitur Planin strategjik (2019-2021) dhe Planin vjetor të cilët ishin aprovuar nga menaxhmenti i ministrisë. Në planin vjetor janë planifikuar gjashtë auditime, të cilat mbulojnë vitin 2019 si dhe vlerësimin e adresimit të rekomandimeve të vitit paraprak. Fushëveprim kishin, shpenzimin e buxhetit, menaxhimin e investimeve kapitale, pasurisë, prokurimit dhe burimeve njerëzore. Qasja e auditimit ishte bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të cilat mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të ministrisë.

NJAB kishte finalizuar të gjitha auditimet e planifikuara⁶, ku në secilin raport të auditimit ishte trajtuar edhe zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak. Raportet e auditimit përmbajnë konkluzione dhe rekomandime të cilat identifikojnë disa nga mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të MAPL-së. Numri i rekomandimeve të dhëna gjithsej ishte 30, prej tyre ishin zbatuar gjashtë (6), në proces të zbatimit ishin 20 dhe katër (4) rekomandime nuk janë zbatuar.

Menaxhmenti ka marrë veprime dhe ka përgatitur planet për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raportet e NJAB-së.

NJAB, kishte raportuar në baza të rregullta edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm. Puna e NJAB-it është mbikëqyrur nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm, i cili kishte mbajtur katër takime ku ishin diskutuar raportet e NJAB-së. Gjithashtu, Komiteti i auditimit

⁶ Raportet e finalizuara: Sistemi i menaxhimit të buxhetit, faza e parë; Sistemi i menaxhimit të investimeve kapitale, faza e parë; Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; Menaxhimi i pasurisë; Sistemi i menaxhimit të prokurimit; Sistemi i menaxhimit të buxhetit faza e dytë dhe Sistemi i menaxhimit të investimeve kapitale faza e dytë.

kishte përgatitur raportin e punës për vitin 2019 të cilin e kishte dërguar tek menaxhmenti i ministrisë.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të MAPL-së ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. MAPL kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, katër rekomandime janë zbatuar, një ishte zbatuar pjesërisht, një nuk ishte zbatuar dhe një është i pazbatuar por i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4 (Tabela e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
A1	PFV	<p>Ministri, duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet përmes bashkëfinancimit me komunat, të cilat regjistrohen si investime në vijim në regjistrin e pasurive të ministrisë, nuk fshihen nga regjistrat, derisa këto projekte përfundohen dhe kalojnë në pronësi të komunës përfituese.</p> <p>Ministri, duhet të siguroj se të gjitha obligimet e papaguara prezantohen drejtë dhe saktë në PVF siç kërkohet me rregullat e thesarit për raportimin financiar.</p> <p>Ministri, duhet të siguroj se janë marrë masat e duhura për adresimin e problemeve lidhur me zhvlerësimin, në mënyrë që zyrtari i pasurisë mirëmban regjistrin duke aplikuar zhvlerësimin sipas normave të përcaktuara, në bashkëpunim me MAP.</p>	<p>Menaxhmenti kishte ndërmarrë masa për të adresuar rekomandimin tonë. Ishte bërë transferimi i gjitha pasurive të komunat me përjashtim të komunës së Leposaviqit. Po ashtu ka adresuar rekomandimin që ndërlidhet me obligimet.</p>	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
A2	Procesi i buxhetit	<p>Ministri, të siguroj se bëhet një planifikim i duhur i buxhetit bazuar në nevojat e ministrisë në kategoritë adekuate, duke marrë për bazë planin kontabël të aprovuar nga MF.</p>	<p>Gjatë vitit 2019 nuk kemi hasur në raste të keq-klasifikimit të shpenzimeve nga kategoria investime kapitale për mallra dhe</p>	Rekomandim i zbatuar

			shërbime.	
B1	Procesi i buxhetit	Ministri të rishikoj shkaqet e mos realizimit të buxhetit dhe të ndërmerr veprime përmirësuese në fushat ku projektet kanë dështuar të realizohen. Performanca buxhetore duhet të jetë subjekt i rishikimit dhe monitorimit të rregullt nga menaxhmenti.	Edhe në vitin 2019 buxheti i shpenzuar për mallra dhe shërbime dhe komunalit ishte i ulët.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar
A3	Pagat dhe mëditjet	Ministri, duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet në aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë është mjaft i përhapur edhe në ministritë tjera.	Kanë filluar të mbahen evidenca për vijueshmëri dhe të angazhohen zyrtarët në kryerjen e detyrave përkatëse.	Rekomandim i zbatuar
A4	Mallrat dhe shërbimet	Ministri, të siguroj se janë vendosur kontrollet e duhura në menaxhimin e vazhdueshëm të llogarisë së avanteve si dhe të vazhdoj bashkëpunimin me thesarin, në mënyrë që në afatin më të shkurtër të mbyllë pjesën e mbetur të avanteve të hapura.	Ka diskutime me thesarin, megjithatë problemi nuk është tejkaluar.	Rekomandim i pazbatuar
A5	Investimet Kapitale	Ministri, të siguroj se marrëveshjet e bashkëfinancimit, përmbajnë afatet e qarta kohore për zbatim të projektit dhe të gjitha transaksionet financiare	Nuk janë përsëritur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar

		bëhen në pajtim me procedurat dhe rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.		
A6	Investimet Kapitale	Ministri të siguroj se zyrtari përgjegjës i prokurimit, gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit ndjek rregullat mbi përgjegjësitë e tij në përgatitjen e dosjes së tenderit, duke mos ndërhyrë në modifikimin e specifikacionit teknik pa një bashkëpunim të mirëfilltë me njësinë apo komisionin që ka përgatitur specifikacionin teknik.	Nuk kemi vërejtur raste të tilla gjatë auditimit të vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
B1	Avancet e pambyllura nga vitet paraprake	Ministri në bashkëpunim me Thesarin të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dëshmitë e siguruara nga MAPL-ja, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në RVF.		
A1	Pagesa jo në pajtim me marrëveshjen dhe jashtë kompetencave të MAPL-së	Ministri të siguroj se marrëveshjet e mirëkuptimit të cilat të lidhen për financimin e organizatave tjera buxhetore të bëhen brenda kompetencave të parapara ligjore dhe përmes kategorive ekonomike në të cilat buxhetohen fonde për këto qëllime. Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve, të respektohen në plotësi kushtet e saj në mënyrë që të evitohen pagesat e parregullta.		
A2	Përkrahja e projekteve kapitale për komuna pa kritere	Ministri duhet të siguroj se para financimit të të gjitha projekteve kapitale të komunave, do të caktohen kritere specifike, të qarta, të drejta dhe transparente siç parashihet me ligjin për ndarjet buxhetore.		
C1	Nënvlerësimi i pasurive jo	Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet përmes bashkëfinancimit me komunat, të cilat regjistrohen si investime në vijim në regjistrin e pasurive të ministrisë, nuk		

	financiare kapitale	fshihen nga regjistrat, pa u siguruar se është bërë marrëveshje transferi, janë pranuar teknikisht dhe mund të regjistrohen në regjistër të pasurisë së komunës përfituese.
--	---------------------	---

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Emilija Redžepi.....*Emilija Redžepi*

Ministre - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

Data: 22 Prill 2020, Prishtinë,